

**PËRMBLEDHJE INFORMUESE**

# Shqipëria



**Ekonomia e Shqipërisë shënoi një rritje të moderuar prej 3,4 për qind në terma vjetorë në tremujorin e parë të vitit 2025, duke pasqyruar forcimin e kërkesës së huaj dhe një ngadalësim të lehtë të kërkesës së brendshme.**

**Inflacioni qëndroi nën nivelin 3 për qind, varfëria ra si rezultat i forcimit të tregjeve të punës dhe borxhi publik vijoi tendencën rënëse.**

**Megjithëse rreziqet e jashtme mbeten të pranishme, progresi në procesin e anëtarësimit në BE ka gjasa të mbështesë besimin e investitorëve, vazhdimësinë e politikave dhe rritjen afatgjatë.**

Pavarësisht një ngadalësimi të rritjes së turizmit, sektorët e shërbimeve dhe ndërtimit ishin nxitësit kryesorë të rritjes ekonomike në anën e ofertës, duke kompensuar rëniet në sektorin e bujqësisë dhe sektorë të tjerë të industrisë.

*Ne presim që ekonomia e Shqipërisë të vazhdojë të rritet, e mbështetur nga reformat e forta. Prioritetet kryesore përfshijnë stabilitetin fiskal, zhvillimin e gjelbër, mbrojtjen më të mirë sociale, përmirësimin e shërbimeve digjitale dhe forcimin e lidhjeve me tregjet rajonale dhe ato të BE-së.*

**Massimiliano Paolucci**  
Menaxher i Zyrës së Grupit të Bankës Botërore për Shqipërinë


Kushtet e tregut të punës u përmirësuan, papunësia u ul dhe punësimi u rrit. Rritja e punësimit në sektorin e shërbimeve kompensoi humbjet e vendeve të punës në bujqësi në tremujorin e parë të vitit 2025, duke e ulur shkallën e papunësisë në 8,7 për qind dhe duke e rritur shkallën e punësimit (mosha 15 — 64 vjeç) në 69,5 për qind si për burrat ashtu edhe për gratë. Pavarësisht presioneve inflacioniste nga rritja e pagave, inflacioni mesatar gjatë shtatë muajve të parë të vitit 2025 mbeti i ulët në 2,2%, i mbështetur nga forcimi i lekut dhe ngadalësimi i inflacionit në Eurozonë.

Në gjysmën e parë të vitit 2025, politika fiskale mbështeti kërkesën përmes një lehtësimi të moderuar, me suficitin e përgjithshëm fiskal që u ngushtua në 2,7 përqind të PBB-së nga 4,3 përqind një vit më parë.

Rritja ekonomike e Shqipërisë parashikohet të ngadalësohet në 3,7 për qind në vitin 2025 dhe 3,5 për qind në periudhë afatmesme, për shkak të pasigurive në tregtinë globale dhe ndryshimeve në perspektivën ndërkombëtare. Megjithatë, një zbatim më i shpejtë i reformave të mbështetura nga BE-ja mund të përshpejtojë ritmin e rritjes së të ardhurave për frymë deri në 3,1 për qind mbi skenarin bazë si edhe konvergencën me standardet e jetesës së BE-së.


## Rritja reale e PBB-së

Në përqindje



## Përbërja e Rritjes Vjetore

Në Pikë Përqindje



Burimi: Zyrtar kombëtare të statistikave dhe vlerësimet e stafit të Bankës Botërore.  
Shënim: BP = Ballkani Perëndimor gjashtë vendet; e = vlerësim.



Për më shumë informacion dhe edicionet e mëparshme të Raportit të Rregullt Ekonomik të Ballkanit Perëndimor, kliko [këtu](#).